



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.349/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me ankesën e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik NISMA për Kosovën me seli në Gjakovë, dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, subjektit politik NISMA për Kosovën me seli në Gjakovë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, me datën 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga organizata Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në oborrin e shkollës fillore profesionale “Nexhmedin Nixha” e njëjta përdoret si Qendër e Votimit QV nr. 0203X, është vendosur poster i kandidatit Demë Avdijaj nga radhët e subjektit politik NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është thyer heshtja zgjedhore, dhe nga ky veprim është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1 pika a) dhe b) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në Përgjigje në ankesë të datës 23.10.2017 nga subjekti politik NISMA për Kosovën, theksohet se në momentin e njoftimit të ankesës kemi marrë veprime konkrete duke i kontaktuar shtabin zgjedhorë të degës në Gjakovë, më konkretisht Demë Avdijaj dhe i njëjti deklaroi “ unë e kam vendosur posterin në objektin në afërsi të shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, për të cilin veprim të tij shpreh keqardhje. PZAP-it i ka kërkuar ankesa e tillë të refuzohet si e pa bazuar. Përgjigjes në ankesë në cilësi të provës i ka bashkangjitur deklaratën e Demë Avdijaj .

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat e lëndës, në kuptim të dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 të LZP-së, konstaton se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të provave, fotografisë së bashkangjitur në ankesë ka vlerësuar në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidati për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik, Nisma për Kosovën, Demë Avdijaj, gjatë heshtjes zgjedhore në oborrin e shkollës fillore profesionale “Nexhmedin Nixha” e njëjta Qendër e Votimit QV nr. 0203X është vendosur posteri i kandidatit Demë Avdijaj nga radhët e subjektit politik NISMA.

Andaj Paneli duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Gjakovë, është përgjegjëse për veprimet e saja, pasi që këto veprime paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatët, të përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton se: “24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre”.

Paneli në kuptim të nenit 118 pika dhe nenit 120. të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr. 349/2017 më datën 24.10.2017

Kryesues i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa Konform nenit 118 par.4 të LZP-së.